



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME
Nr.01-060/01-9920/23 datë:19.04.2023



Npi – 01/180 datë: 27.04.2023

Duke u bazuar në nenin 43 dhe 49 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, si dhe në bazë të nenit 3.13 të Rregullores së Punës së Kuvendit dhe Komiteteve, Npi – 01/114 të datës: 26.04.2019, për mbledhjen e Kuvendit të Komunës, të mbajtur më: 27.04.2023, është nxjerrë ky:

E K S T R A K T
PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË -IV- TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË SHTIMES

E mbajtur më: 27.04.2023, (e enjte) në ora 09:00 h. në sallën e Kuvendit.

Në mbledhje kanë marrë pjesë, Kryesuesi i Kuvendit: z.Adnan Ademi, Anëtarët e Kuvendit: z.Përparim Ramusa, z.Adem Ramadani, znj.Adelina Beqaj, znj.Albana Podvorica, znj.Besartë Musliu-Spahija, z.Rahman Jakupi, z.Lumni Amrushi, z.Hasan Avdyli, z.Hamëz Tërshani, z.Besnik Seferi, z.Gëzim Haxhiu, z.Reshat Mujota, z.Asllan Beqaj, znj.Shkurte Mustafa, znj.Saniye Sadiki, znj.Zejnije Veliu, z.Kadri Emini, znj.Rrezartë Ramadani, z.Muhamet Ademaj dhe z.Rexhep Gashi.

Në mbledhje përveç anëtarëve të Kuvendit kanë marrë pjesë edhe: Kryetari, z.Qemaj Aliu, Nënkryetari, z.Faruk Beqa, të gjithë Drejtorët, z.Lulzim Muharremi, zyrtar ligjor, z.Reshat Gashi, Zyrtar për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore, znj.Anita Kurti, shefe e kabinetit të Kryetarit, z.Mefail Mustafa përfaqësues i nga OSBE-së.

Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit Konstattoj, Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes së Kuvendit. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 15.03.2023
2. Pyetje – përgjigje,
3. Propozim-Vendim për zgjedhjen e Komisionit për organizimin e zgjedhjeve për fshatra dhe lagje urbane në Komunën e Shtimes,
4. Shqyrtimi i Raportit financiar të komunës së Shtimes për periudhën Janar-Mars 2023,
5. Bartja e buxhetit të pa shpenzuar nga viti i kaluar në vitin aktual, dhe rritja e kufirit të hyrave,
6. Draft-Strategjia dhe Plani i veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje 2023-2025, (Pas diskutimit publik).
7. Draft- Rregullore për punën e Kuvendit dhe Komiteteve, (Pas diskutimit publik)
8. Draft-Plani Komunal për integritet 2023-2027, (Pas diskutimit publik)
9. Plani Komunal për Ri integrimin e qëndrueshëm të personave të riadhesuar dhe Integrimin e të huajve, në Komunën e Shtimes 2023-2025,
10. Rishqyrtimi i Vendimit Npi-01-81, për Planin komunal për menaxhimin e Mbeturinave 2023-2027, sipas kërkesës të MMPHI-ja Nr.020-282-5-2023,

11. Propozim-vendim për ndryshimin e destinimit të pronës së paluajtshme komunale në N.K. P-01895-4 ZK-Shtime,

12. Propozim -Vendim për pagesën e shpenzimeve të varrimit për qytetarët që varrosen në territorin e Komunës së Shtimes,

13. Informatë nga DZHE për zhvillimin ekonomik të Komunës së Shtimes.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për rendin e ditës.

z.Hamëz Tërshani; Përshëndetje, propozoj që të futet një pikë shtesë: “Rishqyrtimi i vendimit për formimin e Komisionit të Aksionarëve K.R.M “Pastërtia” në Shtime”, që të jetë pikë e dytë e rendit të ditës.

z.Rexhep Gashi; Përshëndetje, jemi të pajtimit me pikat e rendit të ditës, por mendoj se te pika 11 Drejtori nuk ka bërë sqarimin e mirë për planin zhvillimor, nuk mund të ndryshohet destinimi, sepse plani zhvillimor nuk e ka paraparë destinimin dhe jam kundër propozimit të Drejtorit. Kërkoj që pika 11 të shtyhet. Te pika 13 propozoj që të hiqet nga rendi i ditës, sepse nuk e kemi listën e përgjithshme të subvencioneve.

z.Kadri Emini; Përshëndetje, i patëm 3 propozime, sa i përket propozimit të parë për komisionin e “Pastërtisë” me rishqyrtu. Unë mendoj se Komisioni nuk është kompetent për nënshkrimin e kontratës me “Pastërtinë”. Për pikat 11 dhe 13 që u propozua për me u shty, unë kërkoj vetëm rekomandimin nga drejtoria.

z.Reshat Mujota; Përshëndetje, te pika 11 dhe 13 kemi pak material u dashtë drejtoria me na i sjell edhe rekomandimin e pastaj të vendoset a të shtyhet. Te propozim-vendimi për komisionin e aksionarëve, mendoj se këto kanë përgjegjësi dhe është për me u diskutu kjo çështje. Komisioni nuk nënshkruan kontratë për “Pastërtinë”.

z.Besnik Seferi; Përshëndetje, jemi pak të vonuar, por deri sa janë konsoliduar dhe konkursi do të shpallet shumë shpejtë. Pajtohem me diskutimin e përfaqësuesit e LDK-së, se ne më së paku kemi faj.

z.Reshat Mujota; Çdo her u zgjedh në konkurs anëtar i bordit të K.R.M “Pastërtia”, pse nuk e keni shpallë konkursin për anëtarë të bordit, sepse ka qenë në pandemi e ju ka vazhduar mandati.

z.Besnik Seferi; Kemi dy forma të zgjedhjes së anëtarit të bordit sipas ligjit. Ne sipas ligjit do të hapim konkursin. Zgjedhja e anëtarit është në proces të zgjedhjes. Kontrata është kompetencë e DSHP-së e jo e Komisionit të Aksionarëve.

z.Përparim Ramusa; Përshëndetje, po zhvillohet debat për pikën e propozuar e cila ende është e pa miratuar. Fillimisht të miratohet rendi i ditës e pastaj në vazhdim diskutohet për propozimet.

z.Grejtalb Emini, drejtor i DPUKGJ; Përshëndetje, për propozimin e z.Gashit për destinimin e pronës lidhur me pikën 11 nuk paraqet një problem ligjor dhe aty ne nuk kemi për ta distinuuar si rrugë atë pjesë.

z.Kastriot Shabani, drejtor i DZHE; Përshëndetje, emrat e përfituesve të subvencioneve janë publike dhe mundë ti gjeni në web-faqen e Komunës por edhe mundem me ua dërguar juve nuk ka asnjë problem.

z.Rexhep Gashi; Është për keqardhje që thotë drejtori ua dërgojë me E-mail sepse duhet materialin me na dërguar për mbledhje.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Kemi dy propozime nga zotri Gashi dhe zotri Hamza, fillimisht do ta hedh në votim këtë rend dite që e kemi dërguar dhe pastaj propozimet. Në vazhdim Konstatoi Kuorumin prej 21 anëtarëve prezent në mbledhje.

* Kuvendi i Komunës, me 10 vota “Për”, me 11 vota “Kundër” dhe me 0 vota “Abstenim” nuk e miratoi rendin e ditës.

* Kuvendi i Komunës, me 11 vota “Për”, me 10 vota “Kundër” dhe me 0 vota “Abstenim” miratoi propozimin e z.Hamëz Tërshani për me e futë si pikë e dytë (2) shtesë të rendit të ditës, “Rishqyrtimi i Vendimit Npi-01/93, për formimin e Komisionit të Aksionarëve të KRM “Pastërtia”,

* Kuvendi i Komunës, me 11 vota "Për", me 10 vota "Kundër" dhe me 0 vota "Abstenim" vendosi që pikat e rendit të ditës me numër 11 "Propozim-vendim për ndryshimin e destinimit të pronës së paluajtshme komunale në N.K. P-01895-4, ZK-Shtime", si dhe pika 13 "Informatë nga DZHE për zhvillimin ekonomik të Komunës së Shtimes", të shtyhen për shqyrtim, deri në mbledhjen e radhës të Kuvendit.

* Kuvendi i Komunës, me 11 vota "Për", me 10 vota "Kundër" dhe me 0 vota "Abstenim" miratoi rendin e ditës si vijon:

1. Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 15.03.2023,
2. Rishqyrtimi i Vendimit Npi-01/93, për formimin e Komisionit të Aksionarëve të KRM "Pastërtia", (Pikë shtesë)
3. Pyetje – përgjigje,
4. Propozim-Vendim për zgjedhjen e Komisionit për organizimin e zgjedhjeve për fshatra dhe lagje urbane në Komunën e Shtimes,
5. Shqyrtimi i Raportit financiar të komunës së Shtimes për periudhën Janar-Mars 2023,
6. Bartja e buxhetit të pa shpenzuar nga viti i kaluar në vitin aktual, dhe rritja e kufirit të hyrave,
7. Draft-Strategjia dhe Plani i veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje 2023-2025, (Pas diskutimit publik).
8. Draft- Rregullore për punën e Kuvendit dhe Komiteteve, (Pas diskutimit publik)
9. Draft-Plani Komunal për integritet 2023-2027, (Pas diskutimit publik)
10. Plani Komunal për Ri integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe Integrimin e të huajve, në Komunën e Shtimes 2023-2025,
11. Rishqyrtimi i Vendimit Npi-01-81, për Planin komunal për menaxhimin e Mbeturinave 2023-2027, sipas kërkesës të MMPHI-ja Nr.020-282-5-2023,
12. Propozim -Vendim për pagesën e shpenzimeve të varrimit për qytetarët që varrosen në territorin e Komunës së Shtimes.

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 15.03.2023

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

*Kuvendi i Komunës, unanimitisht miratoi Ekstrakt-Procesverbalin nga mbledhja e mbajtur më 15.03.2023.

Pika 2 (Pikë shtesë)

Rishqyrtimi i vendimit për formimin e Komisionit të Aksionarëve të K.R.M "Pastërtia"

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha propozuesit z.Hamëz Tërshani.

z.Hamëz Tërshani; E kam propozuar sepse mendojë se Komisioni është përgjegjës për mos nënshkrimin e kontratës së Komunës me KRM "Pastërtinë".

z.Reshat Mujota; Po quditna me disa anëtarë të Kuvendit. LDK-ja e ka pas anëtarin në komision. Besniku u dashtë menjëher me i udhëheqë procedurat sepse është kryesues i Komisionit. Me datën 02.06.2022 ju ka vazhduar mandati anëtarit të bordit të KRM "Pastërtia" në Ferizaj, z.Ferid Bilallit.

z.Besnik Seferi; Meqenëse i ke vota mundesh me luajtë lojra qfare të duash, por punë më të mirë nuk ka bërë asnjëherë askush. Kemi qenë të sinqertë. Për datën 02 Maj 2023 e kemi bërë ftesën për mbledhje të adiminstrata, dhe nuk e di që ka bërë dikush punë më të mirë e më transarente se puna jonë që e kemi bërë.

z.Reshat Mujota; VV-ja të ka votuar "Kundër" e unë të kam votuar "Për". Ky po mundohet me ndejtë në politikë duke e luajtur rolin e populizmit, duhet me punu drejtë. Propozoj që Besniku të shkarkohet.

z.Besnik Seferi; Duke pa lojra te tilla qe po bëhen në Kuvend unë jamë në gjendje të jap dorëheqje. Unë propozoj që të shkarkohem nga anetari i Komisionit të Aksionarëve sepse unë nuk toleroj që të luhet me personalitetin tim. sepse e di qe i keni votat.

z.Reshat Mujota; Te lutem që tia ndërpreni fjalën secilit që fillon me ofendime të tilla. Fjalë me “Politika të Pista”, këtu jemi në Kuvend dhe unë nuk vi këtu me bë lojra politike.

z.Përparim Ramusa; Ne në emër të PDK-së e kemi votuar kandidatin e LDK-së dhe të VV-së, edhe pse VV-ja nuk e ka votuar anëtarin e vetë, Besniku duhet me ja ditë për nderë PDK-së. Nuk është mirë Besniku me paragjykuar vetëm nëse ka pas me shkarku Vetëvendosja, por pas dhënies së dorëheqjes atëherë e propozojmë një anëtare dhe do ta zgjedhim, mos paragjyko.

z.Kadri Emini; Nëse shkarkohet Besniku për performancë të dobët atëherë duhet të shkarkohet edhe tjetri sepse nuk ka logjikë. Une mendoj se nuk duhet me e aprovuar dorëheqjen e Besnikut sepse ka filluar procedura e zgjedhjes së anëtarit të bordit, unë jam kundër opsionit të dorëheqjes së Besnikut.

z.Hamëz Tërshani; Unë jam për me shkarkuar, por meqenëse Besniku dha dorëheqje atëherë ta zavendesojmë anëtarin e komisionit.

z.Rexhep Gashi; Ti je ai që po e shkel rregulloren, keni filluar mbrapshtë qysh në emrimet e komisioneve. Unë ndihem keq nëse nuk më përkrahë subjekti im, por nëse nuk më përkrahë subjekti tjetër, ti merre dhe e sheh rregulloren.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Nuk po e di se ku e shkela rregulloren une, por ju lus që ta respektoni njëri tjetrin. Për ekonomi flas aq sa di, nuk është etike me thënë je bërë një far pleqnari. I kemi dy propozime dorëheqja dhe shkarkimi i Besnikut.

z.Zejnie Veliu; Përshendetje, po e jap mendimin tim për këtë çështje nuk është mirë të shkohet drejt në shkarkim, a e përkrahim Besnikun a jo ne e dijme vetë. Pse nuk po i perdorni diskutimet në interes të qytetarëve. Kur ka filluar procesi i zgjedhjes së anëtarit të bordit, nuk është mirë.

z.Hamëz Tërshani; Pajtohem me parafolsin që Kryesuesi e ka për obligim me mbajtur një baraspeshë. Ne kërkuam rishqyrtimin e vendimit e jo shkarkimin e Besnikut. Arrogancën e numrave mund ta shihni në Kuvendin e Kosovës.

z.Rrahman Jakupi; Përshendetje, po zgjerohem pak, se po thuhet që PDK-ja nuk po punon në interes të qytetarëve, pastaj ju nuk keni lënë gjë pa bërë. Vetvendosja nuk e ka përkrahë Besnikun dhe e përgëzoj për dorëheqjen. Vazhdojmë me propozimet, kqyrne pak veten.

z.Adem Ramadani; Përshendetje, lidhur me znj. Veliu, votat këtu e perfaqesojnë shumicën e qytetarëve, dhe ë gjitha pikat janë në interes të qytetarëve.

z.Muhamet Ademaj; Përshendetje, Besniku ka bërë një punë të mirë. Opozita është me numra më shumë, por nuk ka arsye për shkarkim.

z.Reshat Mujota; Me fjalën “Politika të pista” nuk duhej të thuhej Te gjitha pikat janë në interes të qytetarëve. Per qata thash nuk jam për punën e komisionit. Unë e propozoj Rexhep Gashin për anëtarë të komisionit që keni dashtë me bërë ju.

z.Besnik Seferi; Unë po e tërhjeku dorëheqjen dhe ta shohë a po më votojnë apo jo, të ua shohë njerzillëkun e juaj.

z.Zejnie Veliu; Reshat, unë po e shoh që fjalimi im nxiti disa reagime, nuk po shtyhem këtu me të kaluarën, por po duam të vazhdojmë me të ardhmen. Ky komision nuk ka faj për çështjen e lidhjes apo jo të kontratës.

z.Lumni Amrushi; Përshendetje, edhe ti po interferon si Kryesues që 2-3 herë le ta shohin qytetarët. Krejt këta këtu e përfaqësojmë një pjesë të qytetarëve. Nuk jam krenarë që e kam votuar Besnikun, sepse është mosmirënjohës, prandaj unë propozoj që të shkarkohet. VV-ja po dëshmon që janë mosmirënjohës.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Ju lus te mos flasim për nivelin qëndror, të flasim këtu për punën në Komunën tonë.

z.Reshat Mujota; Besniku ka ra në dilemë a mu hjekë vetë a jo, tash unë i tregoj a mu hjekë a jo. Zgjidh a po e jep dorëheqjen, a po don unë me të shkarkuar.

Nenkryetari, z.Faruk Beqaj; Përshendetje, ne e kemi në procedurë një memorandum bashkëpunimi për menagjimin e mbeturinave, tani e kemi në procedurë edhe miratimin e planit të menagjimit të mbeturinave. Jemi duke punuar për klasifikimin e mbeturinave, mbeturinat plastike dërgohen në Mirashë. Kemi edhe punë me deponimin për mbeturinat e ngurta, po ashtu kemi problem me 50% të perfshirjes në sistem të ekonomive familjare. Ku i hedhin mbeturinat këto familje, ose në lumë ose në hapësira publike. Ne jemi

të përkushtuar që të bëjmë zgjidhje të qëndrueshme. Kryetari është në Slloveni pikërisht për çështjen e menagjimit të mbeturinave. Rëndësia e Komisionit është e madhe.

z.Asllan Beqaj; Përsëritet, para se me e hedhë në votim shkarkimin e Besnikut, duhet ta sqarojmë se Komisioni nuk ka kompetenca për nënshkrimin e Kontratës. Kërkoj që Hamza të sqarojë se çka ka nënkuptuar me propozimin e dhënë "Rishqyrtimin e vendimit". E Rexha mos të flet për moral politik sepse në secilën parti që e ka ndrruar ka bërë pazare.

z.Rexhep Gashi; Në vitin 2013-2014, PDK-ja faktikisht më ka ofruar drejtori me marreveshje e unë nuk e kam pranuar, e as në vitin 2017-2021. Subjekti Lëvizja për Bashkim e kemi përkrahur VV-në, i kam thene se du me të përkrahë pa asnjë ineteres. Deri këtu e kam pa që nuk e kam gjetë gjuhën e përbashkët si koalicion. Jam opozitë, e kam votuar buxhetin. Ka individ që kanë bërë pazare mas darke.

z.Kadri Emini; Kjo pikë shtesë unë po them se nuk është në harmoni me rregulloren e as me interesin e qytetarëve. Ne si koalicion LDK-AKR nuk do të jemi as "Për" e as "Kundër".

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Kemi dy propozime dorëheqja dhe shkarkimi.

Konstatohet se sallën e Kuvendit në shenjë paknaqësie (bojkoti) e kanë lëshuar 10 anëtarë të Kuvendit nga subjektet politike: LVV-ja dhe LDK-AKR në ora 11:18h, për sa i përket pikës së (2 shtesë), "Rishqyrtimi i vendimit për formimin e Komisionit të Aksionarëve të K.R.M "Pastërtia", me arsyetimin se kjo pikë shtesë nuk është në harmoni me rregulloren e punës, as me interesin e qytetarëve, dhe arsyeja tjetër është se Komisioni i Aksionarëve nuk është përgjegjës fare për mos nënshkrimin e Kontratës së Komunës me K.R.M "Pastërtia" njësia në Shtime, ashtu qysh po pretendon opozita.

Në vazhdim Kryesuesi konstatoi Kourumin prej 12 anëtarëve prezent në mbledhje të Kuvendit.

* **Kuvendi i Komunës, me 11 vota "Për" me 1 votë "Kundër" dhe me 0 vota "Abstenim"** miratoi vendimin për dorëheqjen e z.Besnik Seferit nga anëtari i Komisionit të Aksionarëve të K.R.M "Pastërtia" njësia në Shtime. Kryesuesi i Kuvendit z.Adnan Ademi, ka votuar "Kundër".

z.Reshat Mujota; Unë propozoj që të zëvendësohet me Rexhep Gashin për anëtarë të Komisionit të Aksionarëve për KRM "Pastërtia" – njësia në Shtime.

* **Kuvendi i Komunës, me 11 vota "Për" me 1 votë "Kundër" dhe me 0 vota "Abstenim"** miratoi vendimin për ndryshimin e Vendimit të Kuvendit, Npi-01/93 të datës 29.04.2022, me të cilin zgjedhet z.Rexhep Gashi anëtar i Komisionit të Aksionarëve për KRM "Pastërtia", në përbërjen si vijon:

1. Bedri Zeqiri, - (i emëruar nga Kryetari i Komunës)
2. Bajram Hajrizi - (i zgjedhur nga Kuvendi)
3. Rexhep Gashi - (i zgjedhur nga Kuvendi)

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Dua të jap një sqarim, Vota ime është "Kundër" për arsye se Komisioni i Aksionarëve nuk është aspak përgjegjës për mos nënshkrimin e Kontratës me K.R.M "Pastërtia" - Shtime. Në vazhdim po shkojmë 5 minuta pauzë në ora 11.20h. dhe do të vazhdojmë me pikat tjera.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Po vazhdojmë me mbledhjen në ora 11:25h, vazhdojmë me pikën e 3.

Pika 3

Pyetje – përgjigje

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Lumni Amrushi; Pyetje për DKA-në, e përkrahu propozimin për me i bërë pyetjet me shkrim, mirëpo për disa pyetje nuk kemi marrë përgjigje. Kërkoj që të përgjigjet drejtoria e Arsimit në pyetjet e mija të kaluara?

z.Muhamet Ademaj; Pyetje për DSHP-në, sa është numri i vendimeve për rrënim në komunën e Shtimes, sipas Gjykatës? Pyetje për DSHP-në, far vendimi ka marrë Gjykata për sa i përket objektit për ngushëllime në fshatin petrovë?

z.Reshat Mujota; Kryesues, qytetarët nuk po i dëgjojnë përgjigjet për këtë arsye mos ua moho të drejtën drejtorëve që të përgjigjen me gojë. Unë kam disa pyetje por nuk po i bëj meqenëse nuk janë drejtorët prezent.

z.Përparim Ramusa; Kam pyetje për juve Kryesues dhe Sekretarinë, pse nuk po thirret në mbledhje anëtarë i KPF-së kur nuk kemi një konfirmim nga MAPL-ja, na jepni një Sqarim?

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Ministria na ka thënë se Ministri është jashtë vendit dhe ende nuk e ka nënshkruar vendimin. Kur të vijen ne do ta sjellim në Kuvend.

z.Adem Ramadani; Pyetje për DPUKGJ-në, në rrugën "Ahmet Kaku" është rrëmihur kodra për trotuare, a do të ndërtohet aty ndonjë mur mbrojtës? Pyetje për DPUKGJ-në, te rruga "William Wolker" pjesa e majtë e rrugës është dëmtuar nga automjetet e rënda, kur do ta rregulloni atë pjesë? Pyetje për sektorin e Tatimit në pronë, a figuron që e kam paguar tatimin në pronë unë, meqenëse te platforma E-Kosova që e shfrytëzoj unë tregon se Invalidët e UÇK-së janë të liruar nga disa tatime. (Në vazhdim lexoi një tekst për beneficionet e Invalidëve të UÇK-së. Po du me ditë se a është bërë diçka për lirin e këtyre personave? Për Kryetarin e Komunës, disa veteran po thonë se Kryetari nuk po na pret si duhet, ata duhet të kanë përparësi, kjo është vërejtje e jo pyetje. E kam sjellë një ide për ndërtimin e një monumenti në Reçak. Këtë projekt-propozim unë do ta bëj me shkrim, dhe po kërkoj që ta sillni në Kuvend.

z.Gëzim Haxhiu; Pyetje për DPUKGJ-në, kur parashihet të bëhet rivitalizimi i rrugës "Sami Frashëri"?

znj.Albana Podvorica; Pyetje për Kryetarin e Komunës, ka premtuar furnizim me ujë rregullisht, kurë do të rregullohet uji në këtë pjesë të lagjes.....? Pyetje për ditën e Botës.....? Pyetje për DPUKGJ-në, kurë do të rregullohet dalja te rruga Tranzit konkretisht te "AVAS"? Pyetje për DKA-në, a janë mbajtur ligjëratat për nxënësit e klasës së 9?

z.Asllan Beqaj; Pyetje për DPUKGJ-në, rruga për fshatin Topillë, kurë do të rregullohet kjo rrugë? Pyetje për DPUKGJ-në, kur do të rregullohet parku në fshatin Petrovë te lagja Hysenaj? Po i përsëris pyetjet për qenët endacak dhe për deponitë e mbeturinave?

znj.Besartë Musliu-Spahija; Pyetje për Ekzekutivin, kisha kërkuar që të gjitha varrezat edhe ato të dëshmorëve edhe të veteranëve të hyjnë në marrvëshjen për mirëmbajtjen e varrezave në komunën e Shtimes? Pyetje për DPUKGJ-në, kërkes nga banorët e fshatit Belinc që te rruga "Afrim Musliu" kërkoj që të bëhet një nën kalim sepse aty është shkollë fillore? Pyetje për DPUKGJ-në, po ashtu edhe një kërkesë nga fshati Davidovc që të bëhet një nën kalim?

znj.Adelina Beqaj; Një pyetje e kam bërë në mbledhjen e kaluar për DPUKGJ-në, në fshatin Belinc trotuari është dëmtuar, a do të ndërmerrni diçka, dhe kisha kërkuar që të më përgjigjet tani nëse ka mundësi?

z.Rexhep Gashi; Pyetje konkrete për DPUKGJ-në, te rruga e shkollës së mesme është qelë një kanalizim i ujrave të zeza çka është ndërmarrë, sa her ka të reshura aty bëhet kështu, i kam do foto këtu? Pyetje për DPUKGJ-në, kanalizimi Godanc-Vojnovc është në gjendje të mjerueshme, në dy vene është mbi sipërfaqe, bujqëve aty po ua bëjnë të pa mundur me hy në ara për me i punu, çka do të ndërmerrni aty?

z.Rrahman Jakupi; Po i falënderoj anëtarët e Kuvendit si rasti i Adem Ramadani për idenë që na e ka sjellë një dokument, qytetarët duhet me ditë sepse është e mirëseardhur për fshatin Reçak. Kjo është pyetje e parë? E lus Kryesuesin që me na i sjellë kërkesat në Kuvend?

z.Adem Ramadani; Sqarim: Është e mirëseardhur pyetja e z.Jakupi se pak a shumë qytetarët duan ta dinë për çka po bëhet fjalë. Kemi menduar që kjo të jetë një simbolikë për viktimat e masakrës. Ideja është për ndërtimin e një monumenti në kodrën e bebushit, për me e lanë një histori të kësaj masakre të Reçakut nëse dëshiron dikush me investu aty Qeveria, Komuna, me ba një skulpturë dhe me i shkruar emrat për secilin person që i kan qar atje për me i ekzekutuar. Këtë ide e kanë pëlqyer edhe të tjerët. Shumica e vizitorëve e bëjnë pyetjen se ku konkretisht është vendi ku ka ndodhur masakra, për kodrën e bebushit. Kërkesën do ta bëj me shkrim besoj se do të qitet në Kuvend nga drejtorja, me një rekomandim.

z.Muhamet Ademaj; Ne si LDK-AKR e përkrahim kërkesën e Adem Ramadani.

znj.Rrezartë Ramadani; Pyetje për DSHP-në, pyetjen që e kam bërë më heret lidhur me pusetat e hapura te shkollë profesionale dhe gjetiu, pyetja ime është çka po ndodhë me atë kontratë, dhe cila është arsyeja që ende nuk janë rregulluar?

z.Besnik Seferi; Po i përsëris pyetjet që i kam bërë në mbledhjen e kaluar: Pyetja për DPUKGJ-në, në fshatin Gjyrvoc ka nevojë për ndriçim çka do të bëhet? Pyetja për DPUKGJ-në, në fshatin Gjyrvoc edhe Trafoja e rrymës është shqetësim, sepse janë ankuar se po na i prishë pajisjet, çka do të bëhet me te? Pyetje

Lidhur me Ekskurzionin e nxënësve në Shqipëri, mua më ka ardhur pak keq nga Kompanitë e transportit të udhëtarëve si ofertues që kanë qenë për ekskurzion siq janë "Dili", "Goni" dhe "Cufa Reisen" që nuk e kan marrë Tenderin por e ka marrë "Arditi Turs". Mendoj se duhet që tu ipet përparësi kompanive tona sepse janë tatim pagues të komunës tonë.

z.Reshat Mujota; Po i përgjigjem pyetjes së Besnikut sepse unë kamë qenë anëtarë i Komisionit, edhe i di procedurat qysh kanë shkuar. Kanë ofertuar katër kompani, Qmimi më i lirë ka qenë i "Arditi Turs", deri sa të tjerët kanë pas edhe mungesë të dokumentacionit, kështu që më i përgatituri ka qenë "Arditi Turs". Pastaj edhe ka qu më shumë nxënës pa pagesë. Nëse dëshironi në mbledhjen tjetër mund të ju jap edhe më shumë të dhëna sepse tani nuk i kam këtu. Ne e kemi respektuar Udhëzimin Administrativ.

z.Muhamet Ademaj; Edhe unë pak du me u ndërlidhë për Ekskurzionin e nxënësve në Shqipëri. Më vjen mirë që Reshati ka qenë në Komision, për sa i përket ekskurzionit. Pjesa teorike ndryshe po prezantohet, por krejt ndryshe nga ata po realizohet pjesa praktike, sidomos te pjesa e ushqimit. Ka qenë mirë që dikush me shku nga Komisioni dhe me pa se a po realizohet ajo kontratë ashtu si duhet apo jo. Në të ardhmen edhe unë mendoj se duhet që ti japim përparësi kompanive të Komunës tonë.

z.Grejtalb Emmini, drejtor i DPUKJ; Sa i përket propozim-projektit të Ademit, unë mund të them se Projekti i Masakrës së Reqakut është ende i pa përfunduar plotësisht, sidomos te qështja e muralit mbi varreza. Ideja është me bërë një shpallje për të kërkuar ide nga Artistët pak më gjerë sepse Masakra e Reqakut nuk është vetëm e Komunës tonë, por komplet në nivel të Republikës së Kosovës. Po ashtu ne kemi bërë kërkesë te Agjencioni i monumenteve për këtë projekt sepse ata ka mundësi që këtë vit me e aprovuar me buxhet. Ne mundemi me e dërguar këtë ide në Agjencion si Ekzekutiv dhe Legjislativ dhe nuk besoj që refuzohet. Jo zyrtarisht kemi informata që po diskutohet që të ndërtohet një Muze i memories për viktimat dhe martirët për krejt Kosovën por për shkak të Masakrës së Reqakut të ndërtohet në komunën tonë.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Pauze te drekes per nje ore ne 12:15h.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Mbledhjen e Kuvendit Kryesuesi e vazhdoi në ora 13:35h.

Pika 4

Propozim-Vendim për zgjedhjen e Komisionit për organizimin e zgjedhjeve për fshatra dhe lagje urbane në Komunën e Shtimes

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Rreth kësaj pike a ka diskutime apo po shkopjmë direkt me propozime. Anëtarë të Kuvendit në Komision janë 4 që do të shkojnë. E kemi edhe kuotën gjinore që duhet ta plotësojmë, është mirë që Kuotën ta plotësojmë ne si Kuvend. Kërkoj që t'i jepni propozimet e juaja. Unë si Kryesues i Kuvendit, shkoj automatikisht Adnan Ademi. Hapi diskutimin.

z.Rexhep Gashi; Meqenëse duhet me u përfshi edhe LB-ja atëherë unë e propozoj Reshat Mujotën.

z.Reshat Mujota; Faleminderit, për propozimin nga Rexha, unë e pranoj propozimin. Por jam kandidat i pavarur.

z.Hamëz Tërshani; Në emër të PDK-së unë e propozoj Adem Ramadanin.

z.Adem Ramadani; Faleminderit, për propozimin, nuk do të thotë që ne në Kuvend duhet me e bërë Kuotën gjinore. Ka mundësi me u bërë edhe në fshat. E pranoj propozimin. 8

z.Përparim Ramusa; E përkrahu propozimin e Hamzës, nuk është e thanun që vetëm PDK-ja me e plotësuar kuotën gjinore. Kërkoj që të shkojmë me radhë me propozimet e Kuvendit. Pastaj shkojmë me Ekzekutivin dhe me OJQ-të të votojmë veq e veq.

z.Rrahman Jakupi; Lidhjen që po e beni me rexhistrimin e popullsisë, kjo nuk ka të bëjë asgjë me zgjedhjet, ata e ndihmojnë atë proces, ndërsa ne jemi të thirrur me i gjetë 4 anëtarë të Kuvendit i kemi 4 anëtarë 1 femër e 3 meshkuj.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Nuk e kemi hallin te U. A. por te logjistika, sepse drejtori është në teren.

z.Valon Januzi, drejtor i DAP; Nëse PDK-ja po intersohen me qene meshkuj atëherë unë e propozoj Anita Kurtin.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Duhet ta dimë nëse Anita e pranon këtë propozim për të qenë anëtare e Komisionit për organizimin e zgjedhjeve për fshatra dhe lagje urbane.

znj.Anita Kurti, shefe e Kabinetit të Kryetarit; Përsëritet, unë po e pranoj këtë propozim.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Na duhet edhe emri i përfaqësuesit nga OJQ-së.

z.Valon Januzi, drejtor i DAP; Meqenëse propozime të tilla ka pasë edhe përpara pa ndonjë procesverbal, atëherë ne e kemi propozuar znj.Zhaneta Demiri, anëtare e Komisionit nga OJQ-të.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Lexoi emrat për anëtarë të propozuar: Adnan Ademi, Adem Ramadani, Reshat Mujota, Rrezartë Ramadani, (që është propozuar më heret) Anita Kurti, dhe Zhaneta Demiri, alternativë Bekim Shahini.

z.Përparim Ramusa; Kupto Kryesues ju po nxitni debat, thatë që patjetër duhet me qenë femër. Jemi që t'i fusim në pako propozimet e legjislativit dhe ekzekutivit e pastaj të votojmë veçmas për përfaqësuesin e OJQ-ve.

z.Rrahman Jakupi; Ju po bëni propozime për OJQ-të, po na shtini që ne të pozicionohemi kundër Zhaneta Demirit. Për ne janë të gjithë të mirë, këtu i kemi sjellë 3 emra.

z.Valon Januzi, drejtor i DAP; Ne po sa deklaroam se nuk është mbajtur një mbledhje e OJQ-ve. Nuk jamë kundër asnjë kandidati.

z.Lumni Amrushi; Më mirë po e votojmë në pako e për OJQ-të më vonë.

z.Përparim Ramusa; Unë po i propozoj të njëjtit por në vend të Zhanetës e propozoj Fatlum Rexha.

z.Besnik Seferi; Ne i thejmë dhëmbët kot sepse këta (opozita) i kanë votat. Këtu nuk mund të flisni sikur për fontanë dëshirash, sepse në Shtime janë shumë OJQ-ë. Deri tash thatë jo nuk votojmë në pako e tash u kthyet e po thoni po i fusim në pako, si mund të ju kuptojmë.

z.Muhamet Ademaj; Prej Kuvendit i dhamë propozimet edhe prej Ekzekutivit po Kryesues hedhi në votim propozimet dhe ti votojmë.

z.Adem Ramadani; Për Zhaneta Demirin, nëse e pranon ajo unë kamë me e votuar.

z.Reshat Mujota; E nise mirë këtë pikë, propozoj që të qitet në votim.

z.Kadri Emini; 2 propozimet ne pako e për OJQ-të votojmë veçmas.

z.Lumni Amrushi; Pajtohm me zotëri Eminin dhe me bë një thirrje publike. E bëjmë një thirrje publike për këtë dhe këtu le të vinë e të vendosin.

z.Besnik Seferi; Tash e kuptuam që Zhaneta tha jo me çdo kusht me qenë pjesë e Komisionit. Por jamë me Lumin që OJQ-të ta zgjedhin vet anëtarin e komisionit.

z.Lumni Amrushi; E tërheqi propozimin tim e la propozimin e PDK-së.

z.Valon Januzi, drejtor i DAP; Kjo i përket Kuvendit por nuk është mirë këtu me folë të pa vërteta.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstatoi Kourumin prej 21 anetareve të Kuvendit prezent në mbledhje.

*** Kuvendi i Komunës, me 9 vota "Për" me 11 vota "Kunder" dhe me 1 vote "Abstenim" nuk aprovoi propozimin e parë që Bekim Shahini, të jetë anëtar i komisionit si përfaqësues i OJQ-ve.**

*** Kuvendi i Komunës, me 11 vota "Për" me 5 vota "Kunder" dhe me 5 vota "Abstenim" miratoi vendimin për formimin e Komisionit prej 7 anëtarëve, për të ndihmuar në procesin e zgjedhjes të Këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane në komunën e Shtimes, në këtë përbërje:**

1. Adnan Ademi.....Kryesues i Kuvendit,
2. Reshat Mujota.....Kandidat i pavarur,
3. Adem Ramadani.....Përfaqësues nga subjekti PDK,
4. Anita Kurti.....Përfaqësuese nga Ekzekutivi,
5. Rrezartë Ramadani.....Përfaqësuese nga LDK-AKR,
6. Fatlum Rexha.....Përfaqësues i OJQ-ve, (më vërejtjen që nevojitet konfirmim nga OJQ)
7. (Emri e mbiemri)Përfaqësues i zgjedhur ad-hoc nga fshati, lagja-urbane.

Për propozimin e 6 Fatlum Rexha, vendimi miratohet me vërejtjen që nevojitet konfirmim nga OJQ-të në Komunën e Shtimes.

Pika 5

Shqyrtimi i raportit financiar të Komunës së Shtimes për periudhën Janar-Mars 2023

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha z.Bujar Feratit.

z.Bujar Ferati, ZKF; Përshëndetje, materialin e keni marrë dhe e keni lexuar prandaj do të jem i shkurtër, në vazhdi, lexoi të dhënat kryesore nga dokumenti (shih dokumentin). Nese ka ndonjë pyetje do të përgjigjem.

z.Muhamet Ademaj; E falënderojmë ZKF-në për raportin, buxheti është shpenzuar mirë kur i kemi parasysh katër periudhat. Inkasimi është më i madh për 62%. Ne e përkrahim këtë raport.

z.Reshat Mujota; Kam pasur një problem me E-mail kështu që nuk e kam marrë materialin, dhe më pas nuk më ka ardhur. I kam disa vërejtje, dhe kur i shoh disa shpenzime kam shumë dilema në krahasim me punën që është në teren.

z.Përparim Ramusa; Ky raport nuk duhet me kaluar, prej 1.2 milionve i kemi shpenzuar 6%. Asnjë cent klubeve sportive nuk ua keni nda. Ky raport i shpenzimeve nuk mendoj se duhet votuar.

z.Bujar Ferati, ZKF; Lidhur me pyetjen e Reshat Mujota, mbase edhe kjo pasqyrë ose raport është i shkurtër mirëpo kujt i nevoiten informatat ne e kemi planin e zotimeve dhe pastaj fillojmë edhe me procedurat e shpenzimeve.

z.Asllan Beqaj; Raporti i shpenzimeve e tejkalon raportin nga viti paraprak. Jemi në periudhën e parë dhe pajtohemi me arsyetimin e ZKF-së.

z.Lumni Amrushi; Faleminderit nga ZKF-ja, unë nuk e kam votuar buxhetin dhe nuk mundem me e përkrahë raportin sepse për disa projekte kamë qenë kundër. Ju veq e keni miratuar dhe po shpresoj të përmirësohet.

z.Adelina Beqaj; Te të hyrat vetanake jeni mburrë që i keni pas te hyra 1.4 milion, mirëpo edhe këtë vit kanë me u shku në suficit.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstatoi Kourumin prej 21 anetareve të Kuvendit prezent në mbledhje.

Kuvendi i Komunës, me 10 vota "Për", me 11 vota "Kundër" dhe me 0 vota "Abstenim" nuk e miratoi Raportin Financiar të Komunës së Shtimes për periudhën Janar-Mars 2023.

Pika 6

Bartja e buxhetit të pa shpenzuar nga viti i kaluar në vitin aktual, dhe rritja e kufirit të hyrave

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha z.Bujar Feratit.

z.Bujar Ferati, ZKF; Po flasim për të njëjtën pikë që e kemi diskutuar në mbledhjen e kaluar me shumën e njëjtë dhe me projektet e njëjta. Nëse është e nevojshme unë po e lexojë materialin, ku po bëhet fjalë për bartjen e buxhetit të pa shpenzuar nga viti i kaluar në vitin aktual, dhe rritja e kufirit të hyrave, por besoj se nuk është e nevojshme që prap me ja nis nga fillimi, nëse ka ndonjë pyetje unë do të përgjigjem.

z.Reshat Mujota; Faleminderit për sqarimet në mbledhjen e kaluar unë kam propozuar që të korigjohen këto bartje. Psh. te administrata e kemi të njëjtën shumë, edhe 10 mijë euro në buxhetin që e kemi ba dhe planifikuar vetë. Është keq menagjim. Te subvencionet që ka ardhë e pa ndryshuar, unë prap po kërkoj me shty këtë pikë për mbledhjen e radhës. Kemi vetura në Komunë e në QPS-ë nuk kanë veturë fare. Kërkoj që ta shtyjme këtë pikë sepse unë kam propozime konkrete. Nuk keni nda mjete për shpronsim.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Po kërkoj që ti adresojmë të gjitha çështjet me qëllim që mos të na humbin mjetet, por ti bartim në këtë vit dhe ti aktivizojmë në projekte.

z.Bujar Ferati, ZKF; Ne këto propozime që i kemi dhënë në raport për veturat janë sepse tash së shpejti po na mbyllet kontrata për automjetet që i kemi në shfrytëzim, mendoj se është mirë me kalu, mirëpo nëse mendoni në tërësi me e ndryshuar na del shumë punë te projektet kapitale.

z.Rexhep Gashi; E falënderojë ZKF-në, kemi qenë kundër bartjes e jo kundër projekteve sepse janë projekte të Shtimes.

z.Lumni Amrushi; Faleminderit për përshkrimin. Nuk ka asnjë propozim konkret.

z.Adelina Beqaj; Për shkak të drejtorit të administratës po duhet me i humbë mjetet, nuk është e vërtetë që PDK-ja po i pengon projektet, unë propozoj që me u shty kjo pikë.

z.Hamëz Tërshani; Po, duhet me i përsëritë fjalët nga mbledhja e kaluar, jamë për zgjidhje shumica është deklaruar pro unë jamë pro me ndryshimet.

z.Përparim Ramusa; Ne e kemi pas të njëjtën pikë dhe i kemi pas thënë Kryetarit me na thirrë edhe me bërë zgjidhje, sepse po bëhet fjalë për 350 mijë euro. Nuk e keni bërë, ju i keni grahë kësaj pune pa mend. Te veturat po kërkoni pare për lluks, për mallra e sherbime i keni pas 1.2 milion i keni kërkuar edhe 120 mijë euro. Pse nuk na keni ftuar në konsultime.

z.Bujar Ferati, ZKF; Informatë shtesë plotësuese, mundemi me ndryshu 10 – 15 % të dokumentit, te pjesa ku po mendoni me ndryshu jepni propozimet dhe shkojmë tutje.

z.Reshat Mujota; Nuk është çështja vetëm te veturat, është te çështja e Arsimit, psh. te mbrojtja e kompjuterave, nuk e di qysh e keni punuar atë punë? i tregon disa foto nga telefoni lidhur me shkollat.

z.Muhamet Ademaj; Bartja e mjeteve duhet me u votuar sepse po bëhet fjalë për 350 mijë euro. Shkolla profesionale ka defekte shumë të mëdha.

z.Grejtalb Emini, drejtor i DPUKGJ; Te rregullimi i shkollave kur bëhet planifikimi nuk mundet që aty të futen të gjitha shkollat, emërgjente ka qenë shkolla në Muzeqinë. Gjimnazi nuk është përmend sepse kemi shpresuar në donacion. Ky është propozimi dhe ne gjykojmë që janë në rregull ju propozoni cilat projekte doni me i futë. Këto para duhet me i shpenzuar për të mirën e qytetarëve.

z.Rexhep Gashi; 70 mijë euro është shumë e madhe sepse janë të qytetarëve. KPF-ja po punon jashtëligjshëm, sepse u zgjedhë anëtar i KPF-së dhe nuk po ftohet. Propozoj një pauzë ta shohim dhe ta kalojmë. Kështu qysh po boni ju nuk kalohet.

z.Asllan Beqaj; Edhe unë propozoj për një pauzë 10 minuta dhe ta diskutojmë dhe ta përfundojmë këtë pikë sepse u stërgjatë.

z.Kadri Emini; Është proces normal që kur votohet buxheti nuk mundet 100% me u qëllu. Ekzekutivi i ka paraparë prioritetet. Ideja për propozime është e domosdoshme. Unë jamë për 10 minuta pauzë.

z.Përparim Ramusa; Nuk pajtohem me propozimin, sepse kjo punë nuk mundet me u kry për 10 minuta. Keni pas kohë një muaj me na thirrë për bartjen e mjeteve. Unë propozoj që të shtyhet kjo pikë.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; 10 minuta pauzë për konsultime.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Po vazhdojmë me mbledhjen pas pauzës në ora: 16:33h. Siç po shihet nuk kemi ndonjë zgjidhje, unë do ta qes në votim për shtyrjen e kësaj pike. Në vazhdim Kryesuesi Konstatoi Kourumin prej 20 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje.

***Kuvendi i Komunës, me 12 vota “Për”, me 8 vota “Kundër” dhe me 0 vota “Abstenim” vendosi për shtyrjen e kësaj pike deri në mbledhjen e ardhëshme.**

Pika 7

Draft-Strategjia dhe Plani i veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje 2023-2025, (Pas diskutimit publik)

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë. Pasi që për këtë pikë nuk kishte diskutime, Kryesuesi Konstatoi Kourumin prej 20 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje.

***Kuvendi Komunës, unanimisht miratoi Strategjinë dhe Planin e Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje për periudhën 2023-2025.**

Pika 8

Draft- Rregullore për punën e Kuvendit dhe Komiteteve (Pas diskutimit publik)

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Para se të hapi diskutimin për këtë pikë Kryesuesi lexoi Rekomandimin e KPF-së dhe në vazhdim fjalën ja dha z.Asllan Beqa si Kryetar i Komisionit për hartimin e rregullores për ta prezantuar këtë pikë.

z.Asllan Beqaj; Në këtë draft rregullore për punën e Kuvendit dhe Komiteteve është punuar me përkushtim dhe është nxjerrë ne diskutim publik. Është një draft i mirë sepse kemi punuar të gjithë anëtarët

e Komisionit dhe e kemi shqyrtuar nen për nen. Nuk po hy në detaje për me spjegu draftin por nëse e keni lexuar dhe nëse ka ndonjë pyetje jemi të gatshëm me u përgjigj.

z.Lumni Amrushi; Unë propozojë, që lista e nënshkrimeve për prezencë në mbledhje me u dorzuar për nënshkrim në fillim të mbledhjes, e jo në fund siç është propozuar.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Komisioni ka votuar unanimisht për këtë pjesë të prezencës.

znj.Adelina Beqa; Kamë qenë pjesë e Komisionit është punuar në maksimum, mirëpo po i ngris disa qështje, te shefi i grupit parlamentar, propozoj të përmirësohet minutaszha dhe të bëhet 5+5. Te neni 7.15 kemi hapësirë të diskutojmë edhe për 2 minuta shtesë pas sqarimit nga Egzekutivi.

z.Asllan Beqaj; Sqaroi nenin 7. Pajtohem sa i përket nenit 7.15.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; E kemi pa të arsyeshme që ta lëmë listën te tavolina dhe të nënshkruhen. Në vazhdim Kryesuesi Konstatoi Kourumin prej 20 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje.

Kuvendi Komunës, unanimisht miratoi Rregulloren e Punës së Kuvendit dhe Komiteteve me ndryshime.

Pika 9

Draft-Plani Komunal për integritet 2023-2027, (Pas diskutimit publik)

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë. Meqenëse nuk kishte diskutime, në vazhdim Kryesuesi Konstatoi Kourumin prej 18 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje.

Kuvendi Komunës, unanimisht miratoi Planin e Komunës së Shtimes për Integritet 2023-2027.

Pika 10

Plani Komunal për Ri integrimin e qëndrueshëm të personave te riatdhesuar dhe Integrimin e të huajve, në Komunën e Shtimes 2023-2025

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha z.Ibrahim Demirit.

z.Ibrahim Demiri, përgjegjës i ZKKK; Përsëndetje, është me rëndësi të theksohet fakti se ky plan nuk ka me shku ne diskutim publik, sepse nuk ka implikime buxhetore, krejt plani është për nivelin qëndror. Ne i kemi përpunuar të gjitha dokumentet lidhur me këtë plan, po ashtu e kemi analizuar edhe bazën ligjore, të cilën e keni të shkruar në tekstin e dokumentit. Ky plan i komunës për ri integrimin e qëndrueshëm të personave te riatdhesuar dhe Integrimin e të huajve është në vazhden e planit në nivel qëndror. Besoj se dokumentin e keni lexuar dhe nuk ka nevojë për me hy në detaje, por nëse ka ndonjë pyetje do të përgjigjem. Ju ftoj që ta miratoni sepse është në të mirën e kësaj kategorie të qytetarëve.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstatoi Kourumin prej 17 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje.

*** Kuvendi Komunës, unanimisht miratoi, Planin Komunal për Riintegrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në komunën e Shtimes, 2023 – 2025.**

Pika 11

Rishqyrtimi i Vendimit Npi-01-81, për Planin komunal për menaxhimin e Mbeturinave 2023-2027 sipas kërkesës të MMPHI-ja Nr.020-282-5-2023

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë. Meqenëse nuk kishte diskutime, në vazhdim Kryesuesi Konstatoi Kourumin prej 18 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje.

*** Kuvendi i Komunës, unanimisht miratoi, korrixhimin e bazës Ligjore të Vendimit të Kuvendit të Komunës së Shtimes Npi-01/81, dt. 15.03.2023, për miratimin e planit komunal për menaxhimin e mbeturinave 2023-2027, si vijon:**

- Bazuar në nenin 12 pikat 12.1 dhe 12.2. shkronja (d), nenin 17 shkronja (f), nenin 40 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008);

- Nenin 8 pika 1.3, nenin 10 pikat 2, 6, dhe 7, nenin 13 pika 1.2, dhe nenin 15 të Ligjit për Mbeturina Nr.04/L-060; Si dhe Ligjit Nr.08/L-071 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit, Nr.04/L-060 për Mbeturina;
- Nenin 5, pika 3, nënpika 3.5 të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr.03/L-025 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.50/2009);
- Nenin 2, pika 1.5 të Ligjit për Partneritet Publiko-Privat Nr.04/L-045 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.26/2011);
- Neni 5 të Statutit të Komunës së Shtimes, 01Nr.06/1636, të datës 03.09.2008;
- Rregulloren e MAPL-së Nr.02/2021, për procedurën e hartimit dhe publikimin e Akteve të Komunës;

Pika 12

Propozim -Vendim për pagesën e shpenzimeve të varrimit për qytetarët që varrosen në territorin e Komunës së Shtimes

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë. Meqenëse nuk kishte diskutime, në vazhdim Kryesuesi Konstatoi Kourumin prej 18 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje.

Kuvendi Komunës, unanimisht miratoi Vendimin për caktimin e çmimit në vlerë prej 250 euro për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për të gjithë qytetarët që varrosen në territorin e kufijve administrativë të Komunës së Shtimes.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Pasi që diskutime të tjera nuk ka mbledhjen e përfundoi në ora: 16:57h.

Procesmbajtësi:
Idajet Rexhepi




Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi

